

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur

Viti XXIII, nr. 7021

E shtunë, 14 tetor 2023

Çmimi 0.50 €

Gjykata Speciale
liron Hysni Gucatin,
javën e ardhshme
vjen në Kosovë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

“AMERIKA QËNDRON ME KOSOVËN”, ISHTE MESAZHI QË SOLLËN NË PRISHTINË
SENATORËT AMERIKANË JEANNE SHAHEEN DHE PETER WELCH | FAQE 4-5

SENATORËT AMERIKANË: PËRGJEGJËSIT PËR NGJARJET E 24 SHTATORIT TË JAPIN LLOGARI, SERBIA DO TË BASHKËPUNOJË



Senatoresha amerikane Jeanne Shaheen, gjatë qëndrimit të saj në Kosovë, së bashku me senatorin Peter Welch, në një konferencë për medie mbajtur në Prishtinë, pas takimit me presidenten e vendit,

Vjosa Osmani, ka theksuar se është shumë e rëndësishme që përgjegjësit për sulmin e 24 shtatorit duhet të japin llogari dhe për këtë tha se shpreson që Serbia do të bashkëpunojë. Presidentja Osmani

ka theksuar se populli i Kosovës i është mirënjohës përjetë ShBA-së për përkrahjen e palëkundur për mbrojtjen e Kosovës së pavarur, sovranë, shumetnike e të integruar në strukturat euroatlantike

**HOVENIERI:
PAVARËSISHT SE ÇFARË
ASOCIACIONI DO TË
THEMELOHET, AI DUHET
TË JETË NË PËRPUTHJE
ME KUSHTETUTËN E
KOSOVËS** | FAQE 3



**LISTA SERBE
THOTË SE ËSHTË
E GATSHME TË
MARRË PJESË NË
ZGJEDHJET E
REJA NË VERI**



| FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



“SHQIPONJAT” DREJT
BERLINIT, JA SI MUND
TA VULOSIN KUALIFIKIMIN | F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Betohet “Qeveria emergjente” e Izraelit

JERUSALEM, 13 TETOR - Ligjvënësit izraelitë kanë mbështetur “qeverinë e zgjeruar emergjente”, një ditë pasi kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, njoftoi për bashkimin në ekzekutiv me rivalët e tij, për aq kohë sa të vazhdojë konflikti me militantët palestinezë të Hamasit. Benny Gantz dhe katër anëtarë të partisë së tij u betuan si ministra pa portofol, pasi Parlamenti votoi për qeverinë e re me 66 vota për dhe katër kundër. Para votimit, Netanyahu tha në Parlament se “uniteti që kemi krijuar dërgon mesazhin e një force të madhe”, duke u zotuar se “do ta shkatërrojmë Hamasin”. Lideri opozitar Yair Lapid, ish-aleat i Gantzit, më herët tha se ai nuk do t'i bashkohet qeverisë.

Gjatë një adresimi televiziv, Lapid akuzoi udhëheqësit izraelitë për “dështim të pafalshëm” për shkak të mosparandalimit të sulmit brutal që militantët e Hamasit kryen në fundjavë. Luftimet që nga 7 tetori midis Izraelit dhe militantëve nga Gaza kanë lënë të vranë mbi 1 200 persona në Izrael dhe 1 350 në Rripin e Gazës. Netanyahu dhe Gantz, përmes një deklarate të përbashkët, më 11 tetor njoftuan se janë pajtuar t'i bashkojnë forcat gjatë luftimeve dhe ta formojë “kabinetin e luftës” prej tre anëtarësh, ku do të përfshihet edhe ministri i Mbrojtjes, Yoav Gallant. Në qeveri, po ashtu, kanë mbetur aleatët e Netanyahu të ekstremit të djathtë. Sipas marrëveshjes, Netanyahu është pajtuar ta ndalë reformën në gjyqësor, që ka



ndarë shtetin dhe kundër saj janë organizuar protestat më të mëdha në historinë e Izraelit. Gantz për herë të fundit kishte shërbyer në një kabinet të

Netanyahut më 2020-2021, ekzekutiv që u formua në bazë të marrëveshjes që i mundësonte Gantzit të udhëhiqte në pjesën e dytë të

mandatit të qeverisë. Por, në Izrael atëbotë u shpallën zgjedhje të parakohshme para se Gantz të mund të bëhej kryeministër.

OKB-ja njofton për mbi 400 000 të zhvendosur në Gaza

GAZA, 13 TETOR - Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka njoftuar të premten herët se më shumë se 400 000 njerëz kanë ikur nga shtëpitë e tyre në Rripin e Gazës dhe se 23 punonjës humanitarë janë vrarë qëkur Izraeli i nisi bombardimet hakmarrëse ndaj sulmit nga militantët e Hamasit në Izrael në fundjavë. OKB-ja i ka kërkuar gati 300 milionë dollarë për t'i ndihmuar rreth 1.3 milion civilë në Gaza dhe në Bregun Perëndimor, kryesisht për ndihma ushqimore, pasi furnizimi me ushqim po mbaron. “Zhvendosja masive po vazhdon. Në Rripin e Gazës numri i personave të zhvendosur brenda vendit është rritur për 25 për qind në 24 orët e fundit, duke e tejkaluar shifrën 423 000, dy e treta e të cilëve janë strehuar në shkollat e UNRWA-së”, tha



OKB-ja duke iu referuar agjencisë së refugjatëve palestinezë. Të premten në mëngjes, Ushtria e Izraelite i

paralajmëroi të gjithë që jetojnë në veri të Qytetit të Gazës, të zhvendosen në jug të Rripit të Gazës brenda 24 orëve të ardhshme, duke rritur frikën

për një ofensivë tokësore. Zëdhënësi i OKB-së, Stephane Dujarriq, tha se “është e pamundur që një zhvendosje e tillë të bëhet pa pasoja të

tmerrshme humanitare”. OKB-ja tha se e mori një udhëzim të ndarë nga Ushtria e Izraelit pak para mesnatës të enjten, sipas të cilit, 1.1 milion civilët që jetojnë në veri të Gazës, kanë 24 orë kohë për t'u zhvendosur në jug të vendit. “Ky është kaos, askush nuk e di çfarë të bëjë”, tha Inas Hamdan, një zyrtare e OKB-së për agjencinë e refugjatëve palestinezë në Qytetin Gaza. Gaza është plotësisht e rrethuar dhe e bllokuar nga Izraeli, i cili ka thënë se rrethimi nuk do të përfundojë derisa Hamasi t'i lirojë të gjitha pengjet. Më shumë se 1 400 njerëz janë vrarë në Gaza qëkur Izraeli i nisi bombardimet hakmarrëse, sipas zyrtarëve palestinezë. Hamasi i mori 150 pengje dhe i dërgoi në Gaza gjatë sulmeve të fundjavës në Izrael, ku militantët e tij i vranë 1 300 njerëz.

Ministri italian e krahason Hamasin me nazistët

ROME, 13 TETOR - Ministri i Jashtëm i Italisë, Antonio Tajani, e ka krahasuar grupin militant palestinez, Hamas, me nazistët, në një intervistë me gazetën “La Stampa” të premten. Militantët e Hamasit “nuk janë ndryshe nga nazistët. Ata janë qyqarë. Një ushtar nuk do t'ia hiqte kokën një bebeje dymuajshe. Raketat po vazhdojnë të shkrepën nga Gaza. Hamasi duhet t'i ndalë sulmet me raketa ndaj

Izraelit, përndryshe është e qartë se do të ketë kundërpërgjigje”, tha Tajani për gazetën italiane. Militantët e Hamasit i thyen barrikadat e forta kufitare dhe u futën nga Gaza në jug të Izraelit të shtunën e kaluar, duke i vrarë mbi 1 300 njerëz në qytetet kufitare izraelite, përfshirë mbi 260 në një festival të muzikës, si dhe duke i plagosur 3 000 të tjerë. Izraeli u përgjigj me bombardime të mëdha

ajrore mbi Gaza, duke i vrarë mbi 1 400 palestinezë dhe duke i plagosur më shumë se 6 600 të tjerë. Tajani nënvizoi se Hamasi dhe palestinezët nuk janë të njëjtë. “Palestina është diçka tjetër. Populli palestinez është viktimë e Hamasit”, tha ministri italian. Tajani bëri thirrje që terroristët të izoloohen. “Ne duhet të tregojmë se ka një popull arab i cili nuk ka asgjë të bëjë me ata”.



Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Hovenieri: Pavarësisht se çfarë asociacioni do të themelohet, ai duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës

PRISHTINË, 13 TETOR - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka thënë në një intervistë për "Zërin e Amerikës", se zbatimi i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është një nga mënyrat për ta rritur sigurinë e Kosovës, të cilën e ka cilësuar të brishtë pas ngjarjeve të 24 shtatorit.

Ambasadori Hovenier ka theksuar se Shtetet e Bashkuara do të marrin masa pasi të vërtetohet se kush qëndron prapa atij sulmi që u krye nga individë të cilët kishin armë që nuk mund të blihen në tregun lokal, por duhet një formë strukture shtetërore që t'i ofrojë ato.

Ambasadori Hovenier ka ripërmendur kërkesën që Serbia të bashkëpunojë për ndriçimin e plotë të ngjarjeve dhe vënien e autorëve para drejtësisë. Ai ka thënë se situata e sigurisë mbetet diçka për të cilën janë shumë të shqetësuar dhe Shtetet e Bashkuara. "Ishim thellësisht të shqetësuar për atë që ndodhi në Banjškë dhe më gjerësisht për situatën e sigurisë në veri. Siç mund ta keni dëgjuar gjatë ndërrimit të komandës së KFOR-it, admiral Munch, komandanti i Forcave të Përbashkëta të NATO-s me seli në Napoli, bëri me dije se nga 24 shtatori NATO-ja ka trefishuar numrin e patrullimeve. Këshilli i Atlantikut të Veriut mori vendim për ta rritur ndjeshëm numrin e forcave të KFOR-it. Ne e marrim këtë seriozisht. Situatën aktuale do ta karakterizoj si të brishtë, por të qetë apo më të qetë. Por ju e dini, ka një brishtësi dhe ne jemi shumë të përqendruar për ta menaxhuar situatën dhe të përpiqemi t'i shmangim incidentet e tjera që mund të çojnë në dhunë e që do të ndikojnë, do ta kërcënojnë popullsinë civile atje, por edhe forcat e ligjshme të sigurisë atje, policinë e Kosovës dhe sigurisht edhe praninë ndërkombëtare", ka thënë Hovenier.



Ai ka theksuar se ajo çfarë ndodhi më 24 shtator ishte një krim, ishte një kërcënim për sovranitetin dhe qëndrueshmërinë e rajonit, ku u kërcënuan qytetarët e Kosovës dhe paqeruajtësit ndërkombëtarë në rajon.

Ambasadori amerikan ka thënë se presin që Qeveria e Kosovës të punojë me ShBA-në për të krijuar kushte për qëndrueshmëri më të madhe dhe ulje të tensioneve në veri. "Nëse asgjë tjetër, ngjarjet e 24 shtatorit tregojnë se ekziston një nevojë urgjente për të arritur në një ripozicionim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, një marrëdhënie në të cilën ka respekt të ndërsjellë, një në të cilën mosmarrëveshjet zgjidhen me mjete paqësore, një në të cilën komuniteti etnik serb në Kosovë ndien se respektohet dhe mund të gëzojë disa të drejta për t'i mbrojtur pjesëtarët e tij. E gjithë kjo është pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Është shumë thelbësore të shkohet drejt kësaj, për t'u rikthyer procesit të arritjes së zbatimit të plotë nga të dyja palët të

marrëveshjeve të arritura, Marrëveshjes Themelore dhe aneksit të zbatimit të saj", ka deklaruar Hovenier, duke shtuar se presin të shohin vullnet më të madh politik nga të dyja palët për t'i zbatuar plotësisht ato detyrime. "Unë besoj, qeveria ime beson, se një nga mënyrat për ta rritur urgjentisht sigurinë e Kosovës është përmes zbatimit të Marrëveshjes Themelore dhe Aneksit të zbatimit. Kjo do ta rrisë jashtëzakonisht sigurinë e Kosovës. Prandaj, ne mendojmë se është kaq urgjente të ecim përpara në dialog për ta arritur këtë", ka thënë ambasadori amerikan.

Në pyetjen se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe prej kohësh, që nga dita e parë, është konsideruar si "thembra e Akilit" në procesin e negociatave, duke ngritur shqetësimin se mund të ndikojë në funksionalitetin e Kosovës. Si mund të zbatohet kjo marrëveshje duke trajtuar në të njëjtën kohë shqetësimet e Prishtinës për ndikimin e saj?, Hovenier ka dhënë këtë përgjigje: "Më vjen shumë mirë

që e bëtë këtë pyetje sepse është diçka për të cilën flasim shumë, si publikisht ashtu edhe me Qeverinë e Kosovës. Shtetet e Bashkuara kanë qenë vërtet mjaft të qarta për këtë. Ne besojmë se Kosova ka një detyrim të përhershëm që nga viti 2013 për ta çuar përpara themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Por, ne kemi bërë gjithashtu gjithçka që është e mundur për ta njohur këtë shqetësim. Dhe ne nuk e përjashtojmë shqetësimin se nëse bëhet në mënyrë të gabuar, në fakt mund ta dëmtojë funksionimin e mirë të shtetit të Kosovës, diçka që askush nga ne nuk dëshiron ta shohë. Por kjo është arsyeja pse qeveria ime ka qenë kaq e qartë për ato që unë i quaj parmakë ose kufizime për mënyrën se si duhet të themelohet ai. Dhe më lejoni t'i përsëris ato. Shtetet e Bashkuara besojnë se pavarësisht se çfarë asociacioni të themelohet, duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën aktuale të Kosovës, pra pa ndryshime kushtetuese. Duhet të jetë në përputhje me vendimin e

Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016. Duhet të jetë në përputhje me angazhimin e Bashkimit Evropian se nuk ka kompetenca ekzekutive. Ai duhet të jetë në përputhje me një dokument publik të hartuar me shumë kujdes nga Këshilltari i Departamentit të Shtetit, Derek Chollet dhe i dërguari ynë i posaçëm për Ballkanin, Gabriel Escobar, që i shpalosën të gjitha këto. Ajo që ne shohim është bashkërendimi në mes të komunave me shumicë serbe dhe se si ato i ushtrojnë funksionet që tashmë i kanë sipas Kushtetutës së Kosovës bazuar në planin e Ahtisarit dhe fushat ku i kanë këto përgjegjësi si arsimit, kujdesi shëndetësor, shfrytëzimi i tokës, gjëra të tilla. Gjithashtu, besojmë se duhet të sigurojë transparencë. Sipas planit të Ahtisarit, Qeveria e Serbisë ka të drejtë nëse dëshiron ta ushtrojë atë, të ofrojë mbështetje për komunitetin etnik serb në Kosovë. Por kjo duhet të bëhet në një mënyrë që të jetë në përputhje me strukturën ligjore të Kosovës dhe ta respektojë sovranitetin e Kosovës. Pra, e gjithë çështja e kujdesit shëndetësor apo e sistemit arsimor duhet të jetë transparente dhe në përputhje me ligjet e Kosovës. Ky do të ishte një përmirësim i dukshëm në situatën aktuale. Ai do t'i adresonte shqetësimet e komunitetit etnik serb dhe, ne besojmë, do t'i ndihmonte qëndrueshmërisë. Pra, ne i sfidojmë ata që thonë se për nga natyra e tij, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është i dëmshëm për funksionimin e mirë të shtetit të Kosovës. Ne besojmë fuqimisht se ka mënyra për ta bërë këtë asisoj që në të vërtetë përmirëson funksionin e shtetit të Kosovës duke përmbytur rolin kritik të trajtimit të shqetësimeve reale të komunitetit etnik serb në Kosovë".

Hilli: Propozime interesante do t'u paraqiten Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 13 TETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Serbi, Christopher Hill, tha për televizionin N1 në Serbi, se gjatë takimeve që priten të zhvillohen në Kosovë dhe Serbi, do të ketë "disa propozime interesante për të dyja palët".

I dërguari Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, do të zhvillojë takime në Kosovë dhe Serbi më 21 tetor. Ai do të shoqërohet nga i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, nga i dërguari i Francës Emmanuel Bonn, ai i Gjermanisë Jens Plotner, dhe i Italisë, Francesco Talo.

Sipas Brukselit, qëllimi i vizitës është të shtyhet përpara zbatimi i marrëveshjes drejt normalizimit, që Kosova dhe Serbia arritën më herët gjatë këtij viti.

Hilli, po ashtu, tha se Lajçaku "ka dëgjuar shumë" dhe mendon se

e di "çfarë kanë nevojë Serbia dhe Kosova".

Ambasadori Hill tha se ShBA-ja dëshiron "një Kosovë të pavarur, me një mjedis shumetnik" dhe mënyra përpara, sipas tij, sa iu përket raporteve në mes Kosovës dhe të Serbisë, është normalizimi i raporteve.

Më herët gjatë 12 tetorit, Hilli deklaroi se "dua që Serbia ta kuptojë dhe ta pranojë Kosovën shtet të pavarur". "Njerëzit thonë se Serbia thjesht duhet ta kuptojë se Kosova është shtet i pavarur dhe të lëvizë përpara. Edhe unë do të doja këtë, por fakti është që problemi është më i ndërlikuar", tha ai.

Vizita në Kosovë dhe Serbi e grupit që njihet si "Pesëshja e madhe" është e para që nga sulmi i 24 shtatorit kundër Policisë së Kosovës në Banjškë të Zveçanit.





“AMERIKA QËNDRON ME KOSOVËN”, ISHTE MESAZHI QË SOLLËN NË PRISHTINË SENATORËT AMERIKANË JEANNE SHAHEEN DHE PETER WELCH

Senatorët amerikanë: Përgjegjësit për ngjarjet e 24 shtatorit të japin llogari, Serbia do të bashkëpunojë

Senatorja amerikane Jeanne Shaheen, gjatë qëndrimit të saj në Kosovë, së bashku me senatorin Peter Welch, në një konferencë për medie mbajtur në Prishtinë, pas takimit me presidenten e vendit, Vjosa Osmani, ka theksuar se është shumë e rëndësishme që përgjegjësit për sulmin e 24 shtatorit duhet të japin llogari dhe për këtë tha se shpreson që Serbia do të bashkëpunojë. Presidentja Osmani ka theksuar se populli i Kosovës i është mirënjohës përjetë ShBA-së për përkrahjen e palëkundur për mbrojtjen e Kosovës së pavarur, sovrane, shumetnike e të integruar në strukturat euroatlantike

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë pritur të premtën në takime të ndara senatoren amerikane Jeanne Shaheen dhe senatorin Peter Welch. Pas takimeve që kanë zhvilluar senatorët amerikanë me Osmanin dhe Kurtin, janë paraqitur edhe në konferencat për medie në Presidencë dhe

Kryeministri.

Senatorja e Shteteve të Bashkuara, Jeanne Shaheen, ka theksuar se shpreson se Serbia do të bashkëpunojë për hetimin e sulmit të shtatorit ndaj Policisë së Kosovës dhe se përgjegjësit do të sillen para drejtësisë. Shaheen tha se “ne jemi këtu për ta mbështetur Kosovën”.

Vizita e Shaheen dhe Welch në Prishtinë vjen rreth tri javë pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur serbësh në

fshatin Banjskë, në komunën e Zveçanit, më 24 shtator, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. Në përleshjet që pasuan pastaj në manastirin e fshatit u vranë tre sulmues serbë.

Duke folur rreth kësaj ngjarjeje, Shaheen, e cila është senatore e Nju-Hampshir që nga viti 2009, tha: “Kjo na tregon, po ashtu, se për paqe dhe stabilitet afatgjatë këtu në Kosovë, është një mundësi për ta vazhduar

mbështetjen e Evropës dhe Shteteve të Bashkuar për gjetjen e një bashkëjetese paqësore dhe afatgjatë me Serbinë. E dimë që është shumë shqetësuese ngjarja në veri. Është shumë e rëndësishme që përgjegjësit për 24 shtatorin të japin llogari dhe shpresojmë që Serbia do të bashkëpunojë”, ka thënë ajo, ndërsa e ka vlerësuar pozitive ritjen e numrit të pjesëtarëve të KFOR-it.

Më tej, senatorja amerikane ka pohuar se derisa i shohim sfidat e tjera në Ukrainë, Lindje të Mesme, duhet të kuptohet se konfliktet dhe dhuna nuk janë zgjidhje. “E rëndësishme që të bëjmë krejt çfarë të mundemi për një zgjidhje paqësore në këtë rajon për të siguruar që të mos ketë përhapje të dhunës dhe konfliktit nga ky rajon”, ka deklaruar Shaheen.

Presidentja Osmani ka thënë pas takimit se me senatorët ka

biseduar për ngjarjet e 24 shtatorit, duke e akuzuar Serbinë se po “synon ta destabilizojë tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor duke vepruar si satelit i Rusisë”. Ajo ka shtuar se gjëja më e rëndësishme tani për ta “parandaluar Serbinë nga kryerja e akteve të tilla të agresionit në të ardhmen është që Serbia të mbahet përgjegjëse për aktin e agresionit dhe t’i dorëzojë terroristët në Republikën e Kosovës që ata të përballen me sistemin tonë të drejtësisë”.

Presidentja Osmani ka bërë me dije se mesazhi i senatorëve ishte se “Amerika qëndron me Kosovën” në këtë kohë sfidash për vendin tonë. “Populli i Kosovës i është mirënjohës përjetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës për përkrahjen e palëkundur në mbrojtjen e Kosovës së pavarur, sovrane, multietnike e të integruar në strukturat euroatlantike”, ka

Lista Serbe thotë se është e gatshme të marrë pjesë në zgjedhjet e reja në veri

Prishtinë, 13 tetor - Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka thënë të premten se partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e cila ka mbështetur e Beogradit, është e gatshme të marrë pjesë në zgjedhjet e reja komunale në veri të Kosovës. Ai tha në një konferencë për media në Mitrovicën e Veriut, se Lista Serbe e mori këtë vendim në bashkëpunim me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Rakiq theksoi se tani "topi është zhvendosur në fushën e Prishtinës" dhe se pret që në komunat e veriut të Kosovës të thirren sa më parë zgjedhjet e reja. "Më duhet të them se duhet të jemi të bashkuar dhe në këto kushte të pamundura të përpqemi të jemi krijues të fatit tonë dhe t'i mbrojmë njerëzit. Gjithmonë kemi marrë vendime politike në interes të qytetarëve, duke mos parë nëse ata po

nxjerrin pikë politike", tha Rakiq. Katër komunat me shumicë serbe në veri, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, udhëhiqen nga kryetarët shqiptarë tani, të cilët e morën detyrën pas zgjedhjeve të prillit, të cilat u bojkotuan dhe kundërshtuan ashpër nga serbët lokalë, duke shkaktuar tensionim të situatës. Kosova, pasi u përball me masa ndëshkuese nga BE-ja, u zotua për riorganizimin e zgjedhjeve, por dëshiron ta bëjë këtë vetëm përmes një udhëzimi administrativ i cili ua mundëson qytetarëve t'i shkarkojnë kryetarët e komunave të tyre përkatëse përmes një peticioni. Më 13 shtator ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, Elbert Krasniqi, tha se dorëheqja e kryetarëve shqiptarë të katër komunave me shumicë serbë në veri të Kosovës "është



kërkesë vetëm e Beogradit", duke këmbëngulur se kryetarët mund të largohen nga zyrat vetëm përmes udhëzimit të ri administrativ. Por që nga atëherë gjendja vetëm sa është tensionuar edhe më shumë, pasi Policia e Kosovës u sulmua më 24 shtator nga një grup serbësh të armatosur në fshatin

Banjskë të Zveçanit, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku, më vonë nënkryetari i atëhershëm i Listës Serbe, Millan Radoičiq, e mori përgjegjësinë e sulmit. Kosova e ka akuzuar Serbinë se tentoi ta "aneksojë tërë veriun e Kosovës", gjë të cilën Serbia e ka mohuar.

Më 12 tetor presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u bëri thirrje përfaqësuesve të serbëve në veri të Kosovës ta iniciojnë mbajtjen e zgjedhjeve të reja në Mitrovicën Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Ministri Krasniqi ka thënë në të kaluarën se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në zgjedhje të parakohshme për kryetar të komunës mund të shkohet në rast se kryetari aktual jep dorëheqje; në rast se qytetarët kërkojnë shkarkimin e kryetarit të komunës përmes një peticioni të nënshkruar nga 20 për qind e votuesve të komunës përkatëse; si dhe në rast se kryetari i komunës nuk paraqitet në vendin e punës më shumë se një muaj pa arsye.



deklaruar Osmani. Pas takimit me presidenten Osmani, senatorët amerikanë kanë takuar edhe kryeministrin Albin Kurtin, me të cilin, sipas Shaheen, kanë pasur një bisedë konstruktive. Në një konferencë të shkurtër për medie, pa mundësinë për të bërë pyetje, Shaheen, duke marrë për bazë sulmin terrorist në Banjë të Zveçanit më 24 shtator, tha se stabiliteti

afatgjatë i Kosovës varet nga marrëveshja me Serbinë, përmes së cilës do të mund të adresohen në mënyrë paqësore dallimet mes vendeve. Senatorja amerikane, e cila theksoi se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë shumë të përqendruara në Ballkanin Perëndimor për t'i adresuar shqetësimet që ekzistojnë, tregoi se Uashingtoni shpreson

që "Kosova do ta shohë këtë si mundësi për të shfrytëzuar". "Kemi parë çfarë ka ndodhur kur ka urrejtje, konflikt dhe çështje të pazgjidhura. Qytetarët janë ata që humbasin në një situatë të tillë", ka thënë ajo. Ndërkaq Kurti ka thënë se Serbia duhet të mbahet përgjegjëse dhe të gjitha këto veprime kërcënuese të ndalen në mënyrë që dialogu Kosovë - Serbi të ketë edhe një shans. "Është koha që

Serbia të mbahet përgjegjëse, përndryshe këto sjellje dhe sulme agresive do të vazhdojnë edhe më tutje. I njoftova senatorët që dialogu i lehtësuar nga BE-ja s'mund të vazhdojë sikurse s'ka ndodhur asgjë, s'mund të vazhdojmë punën edhe më tutje. Kapitulli i dialogut për ndërmjetësim duhet t'i marrë parasysh edhe veprimet sulmuese agresive të Serbisë dhe përpjekjet e saj për aneksimin e

Kosovës", ka deklaruar Kurti. Ai tutje ka potencuar se duhet të ndërmerren "një varg hapash" që dialogu të ketë edhe një shans "për të pasur sukses". "Besoj se është shumë e rëndësishme që të kemi një qasje të balancuar, në mënyrë që të dënohet çdo lloj i shkeljes së marrëveshjes bazë të arritur më 22 shkurt në Bruksel dhe aneksuar për zbatim në Ohër më 18 mars të këtij viti", ka thënë Kurti.

Haki Dervishi dhe Neshad Asllani paditin 'Google'-n për diskriminim të gjuhës shqipe

PRISHTINË, 13 TETOR - Gjiganti teknologjik "Google" është paditur në Gjykatën e Lartë të Kalifornisë për mospërfshirjen e gjuhës shqipe në gjuhët e mbështetura nga "Google". Ky diskriminim ka pasur pasoja të mëdha në medie, marketing, investime të huaja, zhvillim ekonomik dhe teknologjik në Shqipëri, Kosovë dhe kudo që flitet gjuha shqipe.

Padia është ngritur nga Haki Dervishi, shtetas amerikan me banim në Palm Springs Kaliforni, i dekoruar rishtazi nga presidenti Biden me Dekoraten dhe Mirënjohjen Jetësore për kontribut të vazhdueshëm për kombin amerikan, dhe dr. Neshad Asllani, mjek i njohur nga Kosova, themelues i "Qendrës Kosovare për të Drejtat e Njeriut" dhe anëtar bordi në organizatën "Dekada për të Drejtat e Njeriut" në Nju-Jork.

Në njoftimin për medie paditësit besojnë se diskriminimi i vazhdueshëm i gjuhës shqipe nga "Google" ka bërë që folësit e gjuhës shqipe të diskriminohen



nga pjesa tjetër e Evropës dhe botës në zhvillimin e biznesit, në marketing dhe gazetari, pasi janë të përjashtuar nga platformat "Google Ads", "Google AdSense" dhe "Google AdMob".

Kontributi i Dervishit dhe dr. Asllanit për Kosovën është shumëdimensional qysh në fillim

të viteve '90. Vlen të ceket dokumentimi i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lobimi i vazhdueshëm në Kongresin Amerikan për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë. Por, sipas dr. Asllanit dhe Dervishit, angazhimi i tyre lobues dhe koordinimi i aktiviteteve për

pranimin e Kosovës në Rotary International më 5 nëntor të vitit 2005, që rezultoi me njohjen e parë ndërkombëtare të Kosovës, do të mbetet një nga momentet më të ndritura të përkushtimit të tyre për kauzën kombëtare. Dervishi dhe dr. Asllani gëzojnë një përkrahje të parzverë të miqve

amerikanë për ta bërë të padrejtën të dukshme. Ata kanë angazhuar edhe avokatë amerikanë për të paditur gjigantin "Google" në Gjykatën e Lartë të Kalifornisë për diskriminim të gjuhës shqipe.

Dedikimi i Dervishit dhe dr. Asllanit për zhvillim të kombit dhe kontributi i tyre i vazhdueshëm për liri, paqe, barazi dhe mosdiskriminim shton besimin se "Google" do të shqyrtojë me interes këtë padi dhe e konsiderojnë shtimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare të mbështetur nga "Google". Kjo do të sjellë risi të mëtejshme të teknologjisë informative duke krijuar mundësi reale për zhvillim ekonomik, punësim, investime të huaja, marketing dhe informim cilësor, duke u mundësuar gazetarëve ta bëjnë punën e tyre edhe më mirë.

Në njoftim theksohet se dr. Asllani dhe Dervishi gëzojnë përkrahje të jashtëzakonshme ndërkombëtare dhe mbesin të hapur për bashkëpunim me të gjithë të interesuarit për këtë çështje të rëndësishme për kombin tonë.

Djali i Adem Demaçit, Shqiptari, viziton familjen Rugova në Velani

PRISHTINË, 13 TETOR - Djali i Adem Demaçit, dr. Shqiptar Demaçi, së bashku me bashkëshorten, Arbërijën dhe djalin, Feniksin, kanë vizituar të enjten familjen Rugova në Velani. Për detajet e këtij takimi ka njoftuar Adnan Merovci. "Në këtë vizitë të familjes së simbolit të qendrës Adem Demaçi, mikpritje i dhuruan zonja Fanë Rugova me djemtë Mendimin e Ukën, si dhe vajzën, Teutën. Ishte ky një takim i përzemërt dhe shumë emocionues duke u çmallur me tregimet dhe rrëfimet e familjarëve e tyre për këto dy figura kolosale. Dr. Shqiptari, i biri i Adem Demaçit, u shpreh se ndihet i nderuar që po viziton familjen e presidentit Rugova, teksa shtoi se komunikimet e tyre janë të një rëndësie të veçantë që nderojnë punën e paraardhësve. Zonja Fanë Rugova, duke e përshëndetur dr. Shqiptarin dhe



familjarët e tjerë, u shpreh mirënjohëse për këtë vizitë e cila ka një domethënie dhe simbolikë të madhe për gjeneratat e reja se

si duhet të respektohen paraardhësit, në këtë rast të dy kolegëve të cilët fillimisht vijnë nga letërsia, pastaj nga kontributi

i tyre për çështjen kombëtare dhe pavarësinë e Kosovës", ka njoftuar Merovci në "Facebook" Sipas këtij njoftimi, dr. Shqiptar

Demaçi theksoi se raportet në mes të presidentit Rugova dhe Adem Demaçit kanë qenë korrekte dhe në shumë raste janë keqinterpretuar nga dashakeqësit. "Ne jemi këtu bashkë për ta vërtetuar këtë dhe ftoj të gjithë njerëzit që kanë dilema të jenë të qetë, sepse tani Rugova dhe Demaçi janë në disponim dhe komunikim të shkëlqyeshëm në amshim, u shpreh Shqiptar Demaçi në këtë takim", ka njoftuar Merovci.

Adnan Merovci ka theksuar se: "Vizita që zhvilluam ishte e përzemërt nga ku dhe rrodhi porosia që të jemi unikë dhe bashkëveprues, sepse kështu më së miri e nderojmë presidentin Rugova dhe bacën Adem Demaçi, e i ndihmojmë Kosovës sonë për të cilën këto dy personalitete, së bashku me të tjerët, dhanë kontribute kolosale".

Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Republikës Çeke

PRISHTINË, 13 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim ambasadorin e ri të Republikës Çeke, Bohumil Mazanek, me rastin e dorëzimit të letrave kredenciale.

Osmani e uroi ambasadorin për detyrën, ndërkaq ambasadori Mazanek tha se do të ketë edhe angazhim më të

madh pas vendimit të presidentit çek, Petr Pavel, për ngritjen e raporteve diplomatike në nivel të ambasadorëve.

Në këtë takim të dyja palët theksuan raportet shumë të mira mes dy shteteve dhe thellimin e mëtejshëm të raporteve, me fokus të veçantë në bashkëpunimin ekonomik

dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët.

Presidentja Osmani e falënderoi për kontributin e dhënë nga Republika Çeke lidhur me liberalizimin e vizave si dhe e njoftoi nga afër ambasadorin lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë pas aktit të agresionit të kryer në Kosovë nga Serbia.



Gjykata Speciale liron Hysni Gucatin, javën e ardhshme vjen në Kosovë

PRISHTINË, 13 TETOR - Gjykata Speciale ka aprovuar kërkesën për lirim të parakohshëm nga burgu në Hagë. Lajmin e ka dhënë gazetari dhe ish-ushtari i UÇK-së, Astrit Gashi.

Gashi ka thënë se Gucati do të jetë në Kosovë javën e ardhshme. "Lirohet Hysni Gucati, ndërsa Gjykata Speciale bën skandalin e radhës ndaj Nasim Haradinajt, të cilit nuk i aprovon kërkesën për lirim të hershëm!", ka shkruar Gashi në "Facebook".

Edhe ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVL të UÇK-së, Faton

Klinaku, ka konfirmuar për mediet se Gjykata Speciale ka marrë vendim për lirim me kusht ndaj Hysni Gucati. I pyetur nëse vendimi i njëjtë është marrë edhe për Nasim Haradinaj, ai tha se ndaj tij një tjetër vendim pritet të jepet pas dy ose tre muajsh. Ish-drejtuessit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së ndodhen në paraburgim në Hagë prej shtatorit të vitit 2020. Më 18 maj të vitit 2022 ata u shpallën fajtorë për pengim të administrimit të drejtësisë dhe u dënuan me nga katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.



Vazhdon nëpër komuna fushata informuese për liberalizimin e vizave



MITROVICË, 13 TETOR - Fushata informuese për liberalizimin e vizave, pas Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit e Podujevës, ka vazhduar edhe në qytetin e Mitrovicës. Kjo fushatë po i informon qytetarët e Republikës së Kosovës për hollësitë e nevojshme mbi lëvizjen e lirë pa viza që do të nisë nga 1 janari i vitit 2024.

Ekipin lëvizës informues e vizatoi zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian,

Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi.

Ai pa nga afër punën e cila po bëhet për informimin e qytetarëve.

Të gjithë qytetarët e vendit pa dallim duhet të jenë të informuar për rregullat e udhëtimit në zonën Shengen e të drejtat e tyre sa i përket lëvizjes së lirë pas 1 janarit 2024.

Duhet të kenë pasaportë biometrike valide, të qëndrojnë vetëm 90 ditë brenda periudhës

prej 180-ditësh, të kenë dëshmi mbi qëllimin e udhëtimit në zonën Shengen, mbi qëndrimin si rezervimi i hotelit apo detajet e vendit ku do të qëndroni, detajet e udhëtimit, duke përfshirë rezervimin e biletës kthyesë, nëse udhëtohet me veturë, dokumentacionin e nevojshëm të veturës dhe dëshmi se keni mjete të mjaftueshme financiare. Në mjetin e fushatës qytetarët mund të bëhen pjesë e kuizit me pyetje rreth BE-së.

Ambasadori Minxhozi merr 'Çelësin e Qytetit' nga kryetari Rama

Prishtinë, 13 tetor - Kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, i dhuroi "Çelësin e Qytetit" ambasadorit të Shqipërisë në Republikën e Kosovës, Qemal Minxhozi, për kontributin e dhënë për forcimin e lidhjeve mes dy vendeve në takimin lamtumirës që pati me të. "E falënderova për shërbimin e jashtëzakonshëm dhe i thashë se do të mbetet gjithmonë ura jonë lidhëse me Shqipërinë. Në përfundim të misionit i dhurova 'Çelësin e Qytetit' për angazhimin dhe ndihmën e

pakursyer për shtetin tonë", ka deklaruar Rama.

Ndërsa ambasadori Minxhozi u shpreh falënderues për mikpritjen e bashkëpuniminin që kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, ka pasur gjithmonë me të gjitha qytetet shqiptare. "Jam vërtet i lumtur që pata mundësinë që përgjatë këtyre viteve që kam shërbyer në Kosovë të bashkëpunoj me një njeri me shumë vlera i cili ka kontribuar në thellimin e bashkëpunimit mes vendeve tona", është shprehur ambasadori Minxhozi.



Deputetja Deliu vizitoi çlirimtarët në Hagë: Të fala keni të gjithë nga ta

HAGË, 13 TETOR - Deputetja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Blerta Deliu, ka vizituar në Hagë Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe çlirimtarët e tjerë. Ajo ka shkruar në "Facebook" se gjatë

kësaj vizite kishte mall, emocion dhe krenari. "Ashtu siç kanë jetuar dhe siç kanë shkruar në Hagë, ashtu i gjeta edhe sot presidentin Thaçi, kryetarin Veseli dhe të tjerët, ballëllartë e krenarë. Biseduam

gjatë për gjithçka, e kryesisht për Kosovën. Ishin shumë të lumtur me fitoren e Kosovës dhe Shqipërisë mbrëmë. Të fala keni të gjithë nga ta: Dielli do të lindë përsëri!", ka shkruar Deliu.

Lidershipi i Odës Amerikane takon Escobarin, flasin për mundësitë e humbura të biznesit në Kosovë për shkak të tensioneve në rajon

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 TETOR - Stabiliteti në Ballkan dhe paqja më e gjerë rajonale ishin temat kryesore gjatë takimit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë me zëvendësndihmëssekretarin Gabriel Escobar. Gjatë diskutimit në Departamentin e Shtetit të ShBA-së, zëvendësndihmëssekretari Escobar nënvizoi lidhjen e rrënjësorë të bashkuara dhe popullit të Kosovës. Ai theksoi rëndësinë e marrëveshjes së Ohrit dhe bëri thirrje për zbatimin e saj të shpejtë nga Kosova dhe nga Serbia. Delegacioni i Odës Amerikane, i udhëhequr nga drejtori ekzekutiv

Arian Zeka, ndau rrëfime të mundësive të humbura të biznesit në Kosovë për shkak të tensioneve në rajon.

Në përgjigje të kësaj, zëvendësndihmëssekretari Escobar theksoi se normalizimi i marrëdhënieve do ta zhblokonte rritjen signifikante ekonomike për Kosovën dhe rajonin më të gjerë. Të dyja palët ranë dakord për rëndësinë e madhe të stabilitetit dhe paqes në Ballkan, si elemente themelore për prosperitet. Më tej u diskutua për ndërlidhjen ndërmjet marrëdhënieve të normalizuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe stabilitetit të përgjithshëm rajonal.

Duke theksuar vizionin e përbashkët për të ardhmen, zëvendësndihmëssekretari



Escobar dhe përfaqësuesit e Odës Amerikane u pajtuan se rruga përpara për Kosovën dhe vendet e

tjera të Ballkanit varet nga hyrja e tyre në Bashkimin Evropian. Ata u pajtuan se një integrim i tillë do të

sillte një epokë të mundësive të shtuara ekonomike si dhe do ta forconte harmoninë rajonale.

Kurti thotë se investimet në e-qeverisje, e-shëndet, digjitalizim në arsim do të kalojnë vlerën e 80 milionë eurove

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ishte pjesëmarrës në hapjen e edicionit të 12-të të Festivalit të Teknologjisë "KosICT" organizuar nga Shoqata e Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë (STIKK), me temën qendrore "Zbuloni kufijtë e rinj".

Duke e cilësuar festivalin "KosICT" një dëshmi të rëndësishme së madhe që ka sektori i TIK-ut në vendin tonë, Kurti në këtë hapje nënvizoi se digjitalizimi mbetet prioritet i lartë i Qeverisë së Kosovës. "Deri në fund të vitit 2025 investimet në e-qeverisje, e-shëndet, digjitalizim në arsim dhe siguri kibernetike në Kosovë do të kalojnë vlerën e 80 milionë eurove. Në bazë të dokumenteve strategjike që kemi plotësuar, deri në vitin 2027 kjo shifër pritet të arrijë në 130 milionë



euro", tha kryeministri, duke shtuar se këto investime përfaqësojnë përkushtimin e institucioneve të palëkundura për t'i fuqizuar qytetarët dhe bizneset, për ta nxitur

inovacionin dhe për të siguruar që Kosova të kapërcejë në sferën e transformimit digjital.

Vetëm këtë javë, siç tha kryeministri, kanë qenë dëshmitarë të disa

çasteve të jashtëzakonshme në rrugëtimin drejt digjitalizimit, duke potencuar miratimin e Strategjisë së re të e-Qeverisjes 2023-2027 që, sipas tij, është një nismë ambicioze

që synon t'i transformojë ndjeshëm shërbimet tona publike, si dhe Strategjinë e re të Sigurisë Kibernetike 2023-2027, e cila trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha aspektet e sigurisë kibernetike.

Kurti ka theksuar se një arritje tjetër të rëndësishme shënon edhe miratimi nga qeveria i programit pesëvjeçar me Bankën Botërore, i titulluar "Forcimi i qeverisjes digjitale për ofrimin e shërbimeve", i cili përfshin një kredi prej 18,5 milionë eurosh që do të financojë mbi 50 % të aktiviteteve në planin trevjeçar të veprimit të Strategjisë sonë të re për E-Qeverisje.

Sivjet nga data 13 deri më 14 tetor festivali "KosICT" do të mbajë aktivitete me diskutime, ide dhe mundësi për rrjetëzim, gjersa e gjitha do të silltet rreth tri temave kryesore: inteligjenca artificiale, siguria kibernetike dhe transformimi digjital.

Në takimet vjetore të FMN-së dhe BB-së, guvernatori Ismaili takoi guvernatorët e bankave qendrore

Prishtinë, 13 tetor - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, në ditën e katërt të qëndrimit të tij në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) që po mbahen në Marakesh, ka zhvilluar takime me guvernatorët të bankave qendrore dhe përfaqësues të lartë të institucioneve financiare botërore.

Guvernatori Ismaili ka bashkëbiseduar me guvernatorin e Bankës Kombëtare të Austrisë, Holzmann, edhe me atë të

Bankës së Shqipërisë, Sejko.

Në takime të ndara, guvernatori Ismaili ka diskutuar me presidentin e Bankës Tregtare dhe Zhvillimore të Detit të Zi, Koxsal, drejtorin ekzekutiv të Konstituencës në BB, Demircan dhe zëvendëskryetarin e Forumit të Institucioneve Monetare dhe Financiare (OMFIF) dhe shefin Global të Bankimit Ekzekutiv në DZ Bank AG, Scheidig.

Po ashtu, i pari i BQK-së zhvilloi takime me ministrat e financave të konstituencës nga Sllovenia, Bostjančiq, atë të Belgjikës, Van Peteghem dhe

zëvendësministrin e Turqisë, Çelik. Në këto takime guvernatori Ismaili ka biseduar lidhur me bashkëpunimin, mundësinë e zgjerimit të asistencës dhe portofolit të investimeve, si dhe anëtarësimin në mekanizma ndërkombëtarë për bankat qendrore dhe politikat ekonomike.

Guvernatori Ismaili, gjithashtu, mori pjesë në sesionin në të cilën është diskutuar tema mbi stabilitetin e çmimeve, nën drejtimin e guvernatorit të Bankës së Spanjës, Hernandez de Cos dhe drejtorit për



Evropën i FMN-së, Kammer. Gjatë ditës guvernatori Ismaili do ta nënshkruajë marrëveshjen për anëtarësim të Bankës Qendrore të Republikës

së Kosovës në Programin e Thesarit të Bankës Botërore "Reserve Advisory & Management Partnership" (RAMP).

Sfida më e madhe në gjysmë shekulli, për Izraelin



Nuk është shumë dramatike të thuhet se sulmi i djeshëm ishte sfida më e rëndësishme ushtarake ndaj Izraelit në gjysmë shekulli, që nga Lufta e Yom Kipurit e vitit 1973 (e njohur edhe si Lufta e Tetorit), kur një koalicion shtetesh arabe nisën së bashku një sulm të befasishëm. Hamasi organizoi sulmin në shkallë të gjerë pothuajse 50 vjet nga dita e fillimit të atij konflikti. Dhe askush nuk e pa të vinte. Izraeli thotë se tani është shumë i vendosur për luftë.

“Ky nuk është një i ashtuquajtur operacion ushtarak, as një “raund” tjetër luftimesh”, deklaroi kryeministri Benjamin Netanyahu, teksa urdhëroi një rekrutim të gjerë rezervistësh dhe mobilizim të forcave për të luftuar. “Armiku ynë do të paguajë një çmim që nuk e ka parë kurrë. Jemi në luftë, do të fitojmë”.

Retorika e kujdesshme që shfaqet ndonjëherë në fjalimet e zyrtarëve izraelitë në kohëra përshkallëzimi ushtarak, duke përfshirë fraza si “reagim proporcional” dhe “mbrojtje”, mungonte në këtë deklaratë.

Këtë herë është ndryshe. Dhe pasojat do të jenë të mëdha. Fjalimi i Netanyahu ka të ngjarë të vendosë të gjitha opsionet në tryezë, nga një pushtim i afërt tokësor i Gazës, siç nuk e kemi parë kurrë më parë, deri te ridislokimi i mundshëm afatgjatë i ushtarëve izraelitë brenda Gazës. Do të ishte i pari që nga tërheqja e njëanshme e Izraelit nga Rripi i vogël i Gazës në vitin 2005.

Do të ketë pasoja për Bregun Perëndimor të paqëndrueshëm, të pushtuar, ku në muajt e fundit dhuna është rritur dhe ku rreth 200 palestinezë janë vrarë në sulmet ushtarake izraelite vetëm këtë vit. Izraeli ka të ngjarë ta zhvendosë egërsinë e reagimit, pasi të sigurojë jugun, në perëndim.

Negociatat e paqes midis izraelitëve dhe palestinezëve kanë qenë prej kohësh të vdekura, por çdo dritë shprese për të rindezur idenë e një zgjidhjeje me dy shtete, tani mund të shuhet.

Disa kanë argumentuar me kalimin e viteve, se Izraeli ka

luajtur me kërcënimin ekzistencial të Hamasit dhe fraksioneve militante të lidhura me të.

Tani e tutje, Izraeli do të përmendë 7 tetorin si shembull të një kërcënimi të tillë.

Për izraelitët, do të ketë pyetje të zhurshme, se si ky sulm nuk u zbulua në radarin e inteligjencës. Izraeli është i famshëm si vendlindja e softuerit më të fuqishëm të mbikëqyrjes në botë. Ai ka sy mbi Gaza, që është vetëm 42 km i gjatë dhe 12 km i gjerë.

Kur jeni në Rripin e Gazës, e vetmja konstante është zhurma e pandërprerë e dronëve vëzhgues izraelitë në qiell. Ata kanë inteligjencë në terren. Ata kanë (ose kishin) pothuajse kontrollin e plotë të asaj që ndodh brenda dhe jashtë Gazës përgjatë kufijve të saj, pasi vendosën një bllokadë 16-vjeçare, pas marrjes së dhunshme të Rripit nga Hamasit në vitin 2007. Por me sa duket, ata nuk e kanë parë këtë sulm të afrohej.

Izraelitët në “zarfin e Gazës”, që janë zonat në Izrael rrotull Gazës, po strehohen në shtëpitë

e tyre dhe fshihen ndërsa njerëz të armatosur të Hamasit bredhin rrugëve. Të tjerë izraelitë u thanë rrjeteve lokale se militantët ishin në të vërtetë brenda shtëpive.

Pamjet filmike tregonin civilë izraelitë që vraponin për të shpëtuar jetën nëpër fusha. Klipe të tjera të shpërndara nga media e Hamasit, të cilat nuk mund të verifikoheshin në mënyrë të pavarur, tregonin militantët palestinezë duke mbajtur peng civilë izraelitë, duke marrë ushtarë robër dhe duke sjellë trupat e ushtarëve izraelitë në Gaza. Kishte pamje të gardhit kufitar të copëtuar dhe gjithashtu një tank të shkatërruar izraelit.

Grupi militant libanez Hezbollah, i cili mbështet Hamasin, tha se sulmi ishte një përgjigje ndaj “krimeve të okupimit dhe agresionit izraelit në vendet e shenjta” dhe synonte të dërgonte një mesazh të qartë për botën arabe dhe islame “veçanërisht atyre që përipien për normalizim”.

Kjo deklaratë flet për Arabinë Saudite dhe SHBA. Uashingtoni po punonte për arritjen e një marrëveshjeje që do të

normalizonte lidhjet midis Izraelit dhe Arabisë Saudite për herë të parë, duke ndjekur hapat e Emirateve të Bashkuara Arabe. Arabia Saudite lëshoi dje një deklaratë jashtëzakonisht të shpejtë duke bërë thirrje për “ndalimin e menjëhershëm të përshkallëzimit midis dy palëve”. Deklarata shtoi me kujdes se “mbretërisë i kujtohen paralajmërimet e saj të përsëritura për rrezikun e një situatë shpërthyes, si rezultat i okupimit të vazhdueshëm dhe privimit të drejtave të popullit palestinez.” A ka frikë Riadi nga dhuna brenda kufijve të tij?

Tani për tani situata është shqetësuese dhe gjithnjë e më e dhunshme. Policia izraelite, e cila po thërret gjithashtu të gjithë rezervistët dhe vullnetarët, tha se kishte “21 skena aktive” në jug të Izraelit, duke treguar shtrirjen e sulmit. Raketat ende godasin Izraelin jugor, sirenat ende dëgjohej. Ushtria izraelite nuk e ka marrë ende kontrollin e plotë të jugut.

E vetmja siguri është se ky është një moment përcaktues dhe i përgjyeshëm në histori. / The Independent – Bota.al

Izraeli është në makth: Kush do të jemi, kur të ngrihemi nga hiri?



Nga: **David GROSSMAN**, shkrimtar i përkthyer në më shumë se 30 gjuhë / *The Financial Times*
Përkthimi në anglisht: **Jessica COHEN**
Përkthimi në shqip (nga anglishtja): **Agron SHALA** / *Telegrafi.com*

Rreth 1 000 të vrarë, më shumë se 3 000 të plagosur, dhjetëra njerëz të marrë peng. Çdo i mbijetuar është histori e mrekullueshme e shkathtësisë dhe trimërisë. Mrekulli të panumërta, akte të panumërta heroizmi dhe sakrificash nga ushtarët dhe nga civilët. Shikoj fytyrat e njerëzve dhe shoh tronditje. Mpirje. Zemrat tona janë rënduar nga barrët e vazhdueshme. Pa pushim i themi njëri-tjetrit: është makth. Një makth përtej krahasimit. Nuk ka fjalë për ta përshkruar. Nuk ka fjalë për ta përmbajtur. Gjithashtu shoh ndjenjën e thellë të tradhtisë. Tradhtinë e qytetarëve nga qeveria e tyre – nga kryeministri dhe nga koalicioni i tij shkatërrimtar. Tradhti ndaj gjithë asaj që ne çmojmë si qytetarë dhe në veçanti si banorë të këtij shteti. Tradhti e idesë së tij formuese dhe zotuese. Tradhti ndaj depozitës më të çmuar nga gjithë të tjerat – shtëpisë kombëtare të popullit hebraik – që është dorëzuar tek udhëheqësit për ta mbrojtur dhe të cilën ata do të duhej ta kishin trajtuar me respekt. Por, në vend të kësaj, çfarë kemi parë? Atë çfarë jemi mësuar të shohim, thuajse gjithçka ishte e pashmangshme? Ajo që kemi parë ishte braktisja e plotë e shtetit në favor të agjendave të vogla, lakmitare dhe të politikave cinike, mendjengushta, delirante. Ajo që tash po ndodh është çmimi

konkret që po paguan Izraeli duke qenë, për vite me radhë, joshje për udhëheqjen e korruptuar që atë po e çon nga e keqja te më e keqja; udhëheqje që po gërryen institucionet e ligjit dhe të drejtësisë, ushtrinë, sistemin arsimor; udhëheqje që ishte e gatshme ta vendoste vendin në rrezikun ekzistencial, me qëllimin për të mbajtur kryeministrin jashtë burgut.

Tashti, vetëm mendoni se me çfarë kemi bashkëpunuar përgjatë viteve. Mendoni për gjithë energjitë, mendimet dhe paratë që shpenzuam duke parë Netanyahu dhe familjen e tij duke luajtur dramën e tyre të stilit Çausheku. Mendoni për iluzionet groteske që krijuan për sytë tanë mosbesues.

Në nëntë muajt e fundit, miliona izraelitë dolën në rrugë, për çdo javë, për të protestuar kundër qeverisë dhe njeriut në krye të saj. Ishte lëvizje e rëndësishme së madhe, përpjekje për ta rikthyer Izraelin në rrugën e vet, në nocionin fisnik të rrënjëve të ekzistencës së tij: krijimi i një shtëpie për popullin hebraik. Dhe, jo çfarëdo shtëpie. Miliona izraelitë donin ta ndërtonin një shtet liberal, demokratik, paqedashës që respekton besimin e të gjithë njerëzve. Por, në vend që të dëgjonte se çfarë kishte për të ofruar kjo lëvizje e protestës, Netanyahu zgjodhi ta diskreditonte, ta përshkruante si tradhti, të niste kundër saj, të thëllonte urrejtjen midis faktorëve të saj. Megjithatë, e shfrytëzoi çdo mundësi për të deklaruar se sa i fuqishëm ishte Izraeli, sa i vendosur dhe mbi të gjitha – sa i përgatitur ishte për ta përballuar çdo kërcënim.

Është mirë t'ua thuash këtë prindërve që po çmenden nga pikëllimi, foshnjës së hedhur

mëtanë rrugës. Pengjeve. Njerëzve që të votuan. Tetëdhjetë çarjeve të gardhit më të avancuar kufitar në botë.

Por, mos gaboni dhe mos u ngatëroni: me gjithë tërbimin ndaj Netanyahu dhe njerëzve të tij dhe politikave të tij, tmerri i këtyre ditëve të fundit nuk u shkaktua nga Izraeli. U krye nga Hamasi. Pushimi është krim, por të vrasësh qindra civilë pa mëshirë – fëmijë dhe prindër, të moshuar dhe të sëmurë – është krim më i keq. Edhe në hierarkinë e së keqes ekziston një “renditje”. Ekziston shkalla e ashpërsisë që arsyen jonë e shëndoshë dhe instinktet natyrore mund ta identifikojnë. Dhe, kur sheh fushat e vrasjes në lokacionin e festivalit muzikor, kur sheh terroristët e Hamasit me motoçikleta që ndjekin të rinjtë që zbavitën, disa prej të cilëve vazhdojnë të kërcëjnë pa kuptuar se çfarë po ndodh ...

Nuk e di nëse operativët e Hamasit duhet të quhen “kafshë”, por padyshim që kanë humbur njerëzoren.

Netët dhe ditët i kalojmë si somnambulë. Me përpjekjen për t'i rezistuar tundimit për të parë videot e tmerrshme dhe për t'i dëgjuar thashethemet. Ndjenja e frikës depërton në mesin e atyre që për herë të parë në 50 vjet – që nga lufta e Jom Kipurit – po përjetojnë perspektivën e tmerrshme të humbjes.

Kush do të jemi, atëherë kur ngrihemi nga hiri dhe kur futemi sërish në jetën tonë? Atëherë kur në thelb ndiejmë dhimbjen e fjalëve të autorit Haim Gouri, të shkruara gjatë luftës arabo-izraelite të vitit 1948: “Sa të shumtë janë ata që nuk janë më me ne”. Kush do të jemi dhe çfarë lloj qeniesh njerëzore do të jemi pasi shohim atë që kemi parë? Ku do t'ia fillojmë pas shkatërrimit dhe humbjes së kaq

shumë gjërave që çmonim dhe besonim?


Nëse mund të hamendësoj: pas luftës, Izraeli do të jetë shumë më i djathtë, më militant dhe më racist. Lufta e detyruar do të çimentojë stereotipat dhe paragjykimet më ekstreme dhe më urrejtëse që mund ta etablojnë – dhe do të vazhdojnë edhe më shumë ta etablojnë – identitetin izraelit. Dhe, ky identitet tash e tutje do të mishërojë edhe traumën e tetorit 2023, si dhe polarizimin, përçarjen e brendshme.

A është e mundur se ajo që humbi – ose pafundësisht u pezullua – më 7 tetor, ishte shansi i vogël për dialog të vërtetë, për pranimin e vërtetë të ekzistencës së tjetrit nga secili komb? Dhe, çfarë thonë tani ata që vringëllonin me nocionin absurd të “shtetit binacional”? Izraeli dhe Palestina, dy kombe të shtrembëruara dhe të korruptuara nga lufta e pafundme, nuk mund të jenë as kushërinj me njëri-tjetrin – a beson ende dikush se mund të jenë binjakë të bashkuar? Do të duhet të kalojmë shumë vite pa luftë, para se të mund të merret parasysh pranimi dhe shërimi. Ndërkohë, ne vetëm mund t'i paramendojmë përmasat e frikës dhe të urrejtjes që do të dalin në sipërfaqe. Shpresoj dhe lutem se do të ketë palestinezë në Bregun Perëndimor të cilët, pavarësisht urrejtjes së tyre ndaj Izraelit – okupatorit të tyre – do ta distancojnë veten qoftë me veprim apo me fjalë nga ajo çfarë kanë bërë bashkatdhetarët e tyre. Si Izraelit, nuk kam të drejtë t'ju predikoj apo t'ju them se çfarë duhet të bëjnë. Por, si genie njerëzore kam të drejtë – dhe detyrim – të kërkoj prej tyre një sjellje njerëzore dhe morale.

Nga fundi i muajit të kaluar, udhëheqësit e Shteteve të Bashkuara, të Izraelit dhe të Arabisë

Saudite, me entuziazëm folën për një marrëveshje të paqes midis Izraelit dhe sauditëve, që do të bazohej në marrëveshjet e normalizimit të Izraelit me Marokun dhe me Emiratet e Bashkuara Arabe. Palestinezët pothuajse nuk janë të pranishëm në këto marrëveshje. Netanyahu arrogant dhe me vetëbesim, ia doli – sipas fjalëve të tij – të shkëpuste lidhjen mes problemit palestinez dhe marrëdhënieve të Izraelit me shtetet arabe. Marrëveshja izraelito-saudite nuk është e ndarë nga ngjarjet e “Të shtunës së zezë” midis Gazës dhe Izraelit. Paqja që do të krijonte është paqe e të pasurve. Është përpjekje për të kapërcyer thelbin e konfliktit. Ditët e fundit kanë vërtetuar se është e pamundur të fillohet me zgjidhjen e tragjedisë së Lindjes së Mesme, pa ofruar zgjidhjen që lehtëson vuajtjet e palestinezëve.

A jemi ne në gjendje të shkundojmë formulat e konsumuara dhe të kuptojmë se ajo që ka ndodhur këtu është shumë e madhe dhe shumë e tmerrshme për t'u parë përmes paradigmeve bajate? Edhe sjellja e Izraelit edhe krimet e tij në territoret e pushtuara për 56 vjet, nuk mund të justifikojnë apo zbusin atë që doli në shesh: thellësinë e urrejtjes ndaj Izraelit, kuptimin e dhimbshëm se ne izraelitët duhet të jetojmë gjithmonë me vigjilencë të shtuar dhe me gatishmëri të vazhdueshme për luftë. Në përpjekjen e pandërprerë për të qenë njëkohësisht Athinë dhe Spartë. Dhe, me dyshimin thelbësor nëse ndonjëherë do mund të jemi në gjendje që ta çojmë një jetë normale, të lirë, të pakufizuar nga kërcënimet dhe nga ankthet. Një jetë të qëndrueshme, të sigurt. Një jetë që është vatër shtëpie.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

“Shqiponjat” drejt Berlinit, ja si mund ta vulosin kualifikimin

TIRANË, 13 TETOR - Shqipëria ka shënuar të enjten fitore të madhe ndaj Republikës Çeke, duke bërë një hap të madh drejt kualifikimit në Kampionatin Evropian, i cili vitin e ardhshëm do të mbahet në Gjermani. Kombëtarja shqiptare renditet e para në Grupin E, me 13 pikë të grumbulluara nga gjashtë

ndeshje, me katër fitore, një barazim dhe asnjë humbje. Fitoren e fundit Shqipëria e ka arritur ndaj Çekisë në “Air Albania” me rezultat 3-0, me golat e Jasir Asanit dhe Taulant Seferit. Ata tash kanë edhe dy ndeshje në këtë grup, sfida të cilat do t'i zhvillojnë gjatë muajit nëntor. E para do të jetë

në udhëtim te Moldavia, teksa në përballjen e fundit u bëjnë konak Ishujve Faroe. Kombëtares shqiptare matematikisht i nevojiten vetëm edhe dy pikë për ta siguruar kualifikimin për herë të dytë në një Evropian, pas atij në Paris të Francës në vitin 2016.



Albion Rrahmani detyrohet t'i nënshtrohet operimit

PRISHTINË, 13 TETOR - Albion Rrahmani ka pësuar të enjten një lëndim në ndeshjen që Kosova e zhvilloi në udhëtim ndaj Andorrës në kuadër të kualifikimeve për “Euro 2024”. Rrahmani është zëvendësuar në minutën 66 të takimit nga ish-bashkëlojtari i tij te Ballkani, Meriton Korenica. Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar se Rrahmani ka thyer kyçin e këmbës së djathtë, me ç'rast duhet t'i nënshtrohet një operimi. “Në

ndeshjen e mbrëmshme Andorrë - Kosovë në kuadër të kualifikimeve për Euro 2024, sulmuesi ynë Albion Rrahmani ka pësuar lëndim, me ç'rast menjëherë është dërguar për ekzaminime mjekësore në spitalin e qytetit në Andorra, La Vella. Pas këtyre ekzaminimeve ka rezultuar se ai ka pësuar frakturë në kyçin e këmbës së djathtë dhe do t'i nënshtrohet operimit. Të gjithë bashkëlojtarët dhe stafi i kombëtares kanë qenë të prekur

nga lëndimi i Albionit, por presin që ai ta kalojë sa më shpejt periudhën e rehabilitimit dhe të kthehet edhe më fuqishëm për ta treguar talentin e tij në skenën ndërkombëtare. FFK-ja është e përkushtuar të kujdeset për shëndetin dhe mirëqenien e Albionit dhe do të bashkëpunojë ngushtë me klubin e tij Rapid Bukuresht dhe ekspertët mjekësorë për të siguruar që operacioni dhe rehabilitimi i tij të jetë sa më i suksesshëm”, ka njoftuar FFK-ja.



Luka Modriç nuk përjashton mundësinë e largimit nga Real Madridi

MADRID, 13 TETOR - Mesfushori kroat Luka Modriç e ka lënë të hapur të ardhmen e tij duke mos përjashtuar një largim eventual nga Real Madridi për shkak të minutave të paktë në këtë edicion të ri të garave. Ka më shumë se një dekadë që prej se Modriçi u bë pjesë e Real Madridit pas një aventure në Ligën Premier me Tottenhamin. Veterani i mesfushës ka kaluar nëpër shumë sfida me “Los Blancos” gjatë këtyre viteve. Madje u cilësua si transferimi më i dobët ndonjëherë nga Real Madridi pas sezonit të tij debutues.



Duke folur javën e kaluar, Carlo Ancelotti është shprehur me vendosmëri se nuk ka ndonjë shans që Luka Modriçi të largohet nga Real Madridi në janar. 38-vjeçari ka startuar në vetëm katër ndeshje këtë sezon, teksa në pesë paraqitje të tjera është futur nga stoli. Në një prononcim të shkurtër për shtypin kroat pas ndeshjes me Turqinë të enjten, Luka është pyetur për fjalët e Ancelottit. “Epo, nuk do të doja të hyja në atë çështje tani, ka ende shumë kohë deri në dimër dhe në fund të vitit. E kam thënë shumë herë, në moshën time nuk mund të planifikosh

asgjë paraprakisht, duhet të shkosh ditë pas dite, ndeshje pas ndeshje dhe do të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja”, ishte shprehur fituesi i “Topit të Artë”. Përveç Modriçit, me mungesë të minutave në lojë po përballet edhe Toni Kroos, vetëm për shkak të paraqitjeve të mira nga lojtarët e rinj si Eduardo Camavinga, Aurelien Tchouameni, Fede Valverde dhe Jude Bellingham. Forma e tyre po e detyron teknikun italian ta marrë vendimin e vështirë për të lënë në bankë dyshen që u solli shumë trofe madrilenëve.

John Chandler, më i miri i javës së tretë në Superligën e Kosovës në basketboll

PRISHTINË, 13 TETOR - MVP i javës së tretë në Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll ka shkruar për basketbollistin e Pejës John Chandler. Ai në derbin ndaj Trepçës ishte i jashtëzakonshëm me 39 pikë, pesë kërcime dhe tri asistime, duke pasur indeksin e javës 38. Përndryshe, Peja ka triumfuar në derbin e javës së tretë të

Prince Caffë Superligës, duke mundur Trepçën me shifrat 92:80 (27:16, 18:16, 25:24, 22:24), duke vazhduar me fitore, që ishte e treta nga tri ndeshje, kurse humbja e parë për mitrovicasit pas dy fitoreve radhazi. Pas një fillimi të barabartë, vendasit janë shkëputur në 27:16, duke e fituar çerekun e parë, ndërsa kanë vazhduar

me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, ku kishin epërsi deri në 19 pikë, 36:17 por, sidoqoftë, mitrovicasit janë rikthyer për ta afruar rezultatit në 41:32. Megjithatë, skuadrat kanë shkuar në pushim me rezultat 45:32. Në periudhën e tretë është zhvilluar lojë me kthesa, ku pejanët kanë rritur epërsinë në

68:48, më pas mitrovicasit i kanë ngushtuar shifrat, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 70:56. Pavarësisht prej përpjekjeve të mysafirëve, Peja e ka menaxhuar epërsinë dhe ka triumfuar 92:80. Më i merituar te Peja për këtë fitore ishte John Chandler me 39 pikë, pesë kërcime e tri asistime, kurse te Trepça më i



dalluari ishte Kevin Davis me 28 pikë, shtatë kërcime dhe tri asistime.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Muhamet R. Humolli shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit B.I -N.T.P "M-R Com" me numër Unik Identifikues 810506222.

- Faton Morina B.I. N.SH. "Poliklinika Morina" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues 810485187.

- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shme "Ymer Prizreni "Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren.

- Egzona Rrustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.

- AGRON PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesën 1-8 SHFMU "MUHARREM BEKTESHI".

- KENAN JONUZI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme te larte "ARKITEKT SINANI".

- BEKIM PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "ISMAIL QEMALI".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

